



**Burimi i energjisë jeni ju.**  
Vi ste izvor energije.  
The source of energy is you.

## Udhëzime dhe këshilla për shpenzim efikas dhe kursim të energjisë elektrike



## ***I nderuar konsumator,***

*Në këtë broshurë janë të shkruara disa udhëzime dhe këshilla shumë praktike për shpenzim efikas dhe kursim të energjisë elektrike, që do t'ju ndihmojnë të menaxhoni më drejt shpenzimet tuaja, si dhe mënyrat se si mund ta kurseni energjinë elektrike, duke i ndihmuar vetes dhe të tjerëve.*

*Kjo është një ndihmesë për ju, për të kuptuar dhe menaxhuar kostot tuaja të energjisë elektrike dhe njëherësh është njëra nga mënyrat që Kompania bën përpjekje të ofrojë informata dhe t'i qëndrojë besnik konsumatorit duke i ofruar shërbime cilësore.*



## **IZOLIMI**



- Bëni termoizolimimin e objekteve të banimit, të bizneseve, të zyrave, që do t'ju mundësojë të kurseni afërsisht deri në 50% të asaj që shpenzoni për ngrohje gjatë dimrit dhe për freskim të ambientit gjatë verës. Me këtë do t'i ndihmoni vetes të kurseni para.
- Izoloni dritaret dhe dyert. Një pjesë e nxehtësisë humbet përmes dritareve dhe dyerve të paizoluara mirë.
- Përveç mureve, izoloni edhe çatitë (kulmet) e shtëpive.
- Në mbrëmje mbyllni kapakët e dritareve ose roletat, sepse pengojnë hyrjen e të ftohtit brenda.
- Mbani të mbyllura dritaret dhe dyert e dhomave, në mënyrë që të ruhet nxehtësia e akumuluar në ato hapësira, ndërsa gjatë verës të ruhet freskia.

## **NGROHJA APO FRESKIMI I AMBIENTIT**

- Është e këshillueshme që mundësisht mos ta përdorni energjinë elektrike për ngrohje gjatë dimrit, por të kërkonit alternativa tjera për ngrohje. Nëse nuk keni alternativë tjetër dhe duhet ta përdorni energjinë elektrike, atëherë ja disa udhëzime dhe këshilla që të zvogëloni shpenzimet tuaja.

## **TERMOAKUMULUESET, RADIATORËT**



- Akumuloni nxehtësinë në termot akumuluese gjatë natës, kur shpenzimi është me tarifë të ulët, (tarifë të lirë).
- Ndërroni nxehtësit e termos nëse janë të vjetër, sepse shpenzojnë dhe nuk ngrohin sa duhet.
- Kontrolloni termostatin a funksionon mirë, sepse mosfunksionimi i termostatit paraqet rrezik për njerëz dhe objekte.


- Temperatura e rregulluar në termostatat të jetë nga 18°C deri 21°C, aq sa preferohen të jenë temperaturat e brendshme.
- Mos i përdorni termot dhe radiatorët për tharje të rrobave, sepse përveç humbjes së nxehtësisë, mund të shkaktohet edhe zjarr.
- Përdorimi i termove akumuluese dhe radiatorëve në mënyrë racionale gjatë dimrit shpenzojnë rreth 60% të energjisë së përgjithshme elektrike për një amvisëri.
- Nëse nuk jeni në objekt disa ditë, shkyçni termot dhe radiatorët.
- Nëse e vendosni termostatin pak shkallë më ulët se zakonisht, atëherë ju do të kurseni rreth 10% të shpenzimit.
- Para se të flini zvogëloni temperaturën e termostatit, sepse është më e shëndetshme dhe do të kurseni.

## **STUFA ELEKTRIKE**



- Gjatë zierjes përshtatni temperaturën adekuate, vendosjani tenxheres kapakun për ta ruajtur nxehtësinë dhe kështu do ta shkurtoni kohën e zierjes.
- Pas arritjes së temperaturës në 100°C, pra, pasi të marrë valë, uleni temperaturën.
- Përdorni enë, fundi i të cilave është në madhësi të pllakës së stufës ose enë, fundi i të cilave është pak më i madh se pllaka e stufës.
- Përdorimi i enëve ekspres për zierje me avull shpejton zierjen dhe është më ekonomike.
- Gjatë përgatitjes së ushqimit në furrë duhet ta dini se çdo hapje e derës së furrës zbret temperaturën rreth 15°C.
- Para se të përfundojë zierja 2-3 minuta ndaleni pllakën apo 5–10 minuta para se të përfundojë pjekja ndaleni furrën, sepse me këtë veprim do të kurseni.
- Ndërrojinini pllakat e stufës apo nxehtësit e furrës nëse janë të vjetër.

## ***NXEHËSI I UJIT (BOJLERI)***



- Varësisht nga përdorimi, lloji dhe kapaciteti, bojleri shpenzon afërsisht 15% të shpenzimit të përgjithshëm të një amvisërie.
- Për ta përdorë në mënyrë më racionale bojlerin, rregullojeni termostatin në temperaturë mes 50°C dhe 55°C.
- Ndërrojeni bojlerin nëse është i vjetër ose ndërrojeni vetëm nxehësin nëse është i vjetër.
- Nëse nuk jeni në shtëpi më gjatë se një ditë, shkyçeni bojlerin.
- Kujdesuni që termostati i bojlerit të jetë çdo herë në gjendje të rregullt, sepse nëse nuk funksionon termostati, uji nxehet pa kontroll dhe mund të paraqet rrezik për njerëz, pra mund të eksplodojë.
- Afërsisht 15 - 30% nga shpenzimi i përgjithshëm i rrymës, shpenzohet vetëm për ta mbajtur ujin të ngrohtë në bojler.
- Përdorni bateri automatike për rregullim (balancim) të ujit të ftohtë dhe të nxehët.

## ***MAKINAT E LARJES, THARJES***




- Makinat për larjen e enëve, për larjen dhe tharjen e rrobave, gjithashtu përbëjnë një pjesë të shpenzimit të përgjithshëm.
- Nëse keni vendosur të blini makinë të re për larjen e enëve, makinë për larje apo tharje të rrobave, atëherë orientohuni në prodhime më cilësore dhe më ekonomike, shikoni udhëzimin e prodhuesit ku janë të shkruara karakteristikat kryesore dhe pastaj vendosni cila është më ekonomike.
- Vendosjen e makinave e bëni në vende të thata e kurrsesi në vende me lagështi, sepse lagështia përçon rrymën dhe paraqet rrezik për njerëz, gjithashtu kontrolloni të jenë në rregull telat e rrymës, kabllot dhe spinat. Gjithashtu kujdesuni që gypat për marrjen dhe zbrazjen e ujit të jenë të vendosur mirë.



Mund të vendoset ventilatori qendror për tërë shtëpinë dhe është më ekonomik.

## **FRIGORIFERI, NGRIRËSI (FRIZI)**



- Nëse keni vendosur të blini frigorifer apo ngrirës të ri, atëherë orientohuni në prodhime më cilësore të klasës “A A”, sepse janë më të qëndrueshme dhe më ekonomike.
- Rregulloni termostatin e frigoriferit në temperaturë mes 3°C dhe 5°C, si dhe të ngrirësit në shkallën I.
- Derën e frigoriferit apo të ngrirësit mbani të hapur sa më pak që është e mundur dhe bëhuni të kujdesshëm që pastaj dera të jetë mirë e mbyllur, sepse depërton ajri i ngrohtë dhe humbet freskia, kështu që atyre u duhet më shumë kohë për të rikthyer gjendjen paraprake.
- Ushqimin e nxehtë apo të ngrohtë mos e vendosni në frigorifer apo ngrirës lëreni të ftohet e pastaj e vendosni brenda tyre.
- Mos lejoni lagështi në frigorifer, mbuloni enët e ushqimit, pastroni pikat e ujit nga të gjitha enët dhe shishet që i vendosni në të.
- Mos e vendosni frigoriferin apo ngrirësin afër burimeve të nxehtësisë, sepse atyre do t’u duhet më tepër kohë dhe shpenzojnë më tepër energji elektrike për ta ruajtur temperaturën e funksionimit.
- Mos lejoni të formohet trashësi e akullit në frigorifer dhe ngrirës, shkrini dhe pastroni ato, sepse do të jenë më efektiv dhe më ekonomik.

## **NDRIÇIMI**



- Ndrichiimi bën pjesë në shfrytëzimet më të dukshme të energjisë elektrike në hapësirat e brendshme dhe ato të jashtme.
- Ju mund të ndërmerrni disa hapa të thjeshtë për të zvogëluar shpenzimet e juaja të ndrichiimit, dhe me këtë veprim do t’i ndihmoni vetes dhe rrethinës, në mënyrë që edhe të tjerët të kenë dritë.

- Mos i lini dritat të ndezura në hapësirat të cilat nuk i shfrytëzoni.
- Në hapësirën e jashtme nëse nuk është e domosdoshme, mos lini shumë drita të ndezura.
- Nëse përdorni më shumë drita, atëherë orientohuni në shfrytëzimin e dritave fluoreshente (të neonit).
- Zëvendësoni dritat inkandeshente, të ngrohta, (poçat elektrik të zakonshme) me dritat fluoreshente (të neonit).
- Dritat fluoreshente (të neonit) shfrytëzojnë 75% më pak energji elektrike dhe qëndrojnë 10 herë më shumë se dritat e zakonshme inkandeshente, pra janë shumë më ekonomike dhe do të kurseni.
- Në hapësira të caktuara mund të vendosni sensorë që aktivizohen dhe ndriçojnë vetëm kur ka lëvizje dhe kështu ju do të kurseni buxhetin tuaj.
- Varësisht nga përdorimi i dritave, ndriçimi në amvisëri mbulon rreth 12% të shpenzimeve të përgjithshme vjetore.

---

**Dritat inkandeshente të ngrohta (poçat e zakonshme) shpenzojnë më shumë dhe qëndrojnë më pak, ndërsa ato fluoreshente (të neonit) shpenzojnë më pak dhe qëndrojnë më shumë.**

---



<b>Dritat</b>	<b>Inkandeshente</b>	<b>Fluoreshente</b>
Kw/h	60 wat	13 wat
Qëndrueshmëria	1,000 orë	10,000 orë
Kw/h	70 wat	18 wat
Qëndrueshmëria	1,000 orë	10,000 orë
Kw/h	100 wat	27 wat
Qëndrueshmëria	1,000 orë	10,000 orë
Kw/h	150 wat	34 wat
Qëndrueshmëria	2,000 orë	10,000 orë
Kw/h	200 wat	42 wat
Qëndrueshmëria	1,000 orë	10,000 orë
Kw/h	300 wat	65 wat
Qëndrueshmëria	1,000 orë	10,000 orë

## **SHPENZIMI NË kWh PËR DISA PAJISJE (IMPIANTE)**

Furra e stufës elektrike	4 kWh
Një pllakë e stufës elektrike	1 kWh
Bojleri	2–3 kWh
Lavatriçja	2.5 kWh
Termoakumuluese	2–6 kWh
Kondicioneri (klime)	1.3–2.5 kWh
Radiator	2–3 kWh
Kaloriferi	2–12 kWh
Thithëset e pluhurit	1.2–1.8 kWh
Hekuri për hekurosje	1–1.5 kWh

## **PAJISJET TJERA**

- Pajisjet e ndryshme elektronike sikurse televizori, kompjuteri, dvd, studio muzikore etj, mos i lini në stand by (drita sinjalizuese) sepse edhe ato shpenzojnë rrymë.

## **UDHËZIME DHE KËSHILLA NË PIKA TË SHKURTËRA**

---

- Izoloni objektet, do të kurseni deri në 50%.
- Izoloni dritaret dhe dyert me shirita dhe shkumë.
- Mbyllni perdet, roletat, kapakët e dritareve.
- Mbani të mbyllura dritaret dhe dyert, të mos humbet nxehtësia.
- Nëse keni mundësi mendoni për ngrohje tjetër, e jo me rrymë.
- Akumuloni nxehtësinë në termot akumuluese gjatë natës me tarifa të ulta (të lira).
- Ndërroni nxehtësit nëse janë të vjetër.
- Kontrolloni termostatin a është në rregull.
- Mos i thani rrobat mbi termo apo radiator.
- Nëse nuk jeni në objekt më shumë se një ditë, shkyçni termot apo radiatorët.
- Vendosni termostatin disa shkallë më ulët, me qëllim që të kurseni.
- Akordoni temperaturën: Në dhomë të ndejës 21°C, në zyrë 20°C, në dhomë të fjetjes 18°C.
- Sipas mundësive përdorni gazin për zierje, është më i lirë dhe zien më shpejt.
- Gjatë zierjes përshtatni temperaturën dhe vendosjani kapakun tenxheres.
- Përdorni enë ekspres për zierje me avull.
- Para se të përfundojë zierja 2-3 minuta, ndalni pllakën e stufës elektrike.
- Mos e hapni derën e furrës gjatë pjekjes, sepse zbret temperatura rreth 15°C.
- Para se të përfundojë pjekja 5-10 minuta, ndaleni furrën.
- Bojlerin e përdorni atëherë kur ju nevojitet.
- Akordoni termostatin e bojlerit mes 50-55°C.
- Ndërroni bojlerin nëse është i vjetër ose ngrohësin e bojlerit.
- Nëse nuk jeni në shtëpi, shkyçeni bojlerin.
- Kujdesuni që termostati i bojlerit të jetë në gjendje të rregullt.
- Makinat për larjen dhe tharjen e rrobave si dhe ato për larjen e enëve i aktivizoni vetëm atëherë kur të jenë të mbushura .
- Pastrimi i rrobave mund të bëhet edhe në temperatura më të ulëta të ujit.
- Makina për tharjen e rrobave preferohet gjithashtu të jetë e mbushur.

- Mos i thani rrobat shumë, sepse ato mund të rrudhen dhe paraqesin vështirësi për hekurosje.
- Përdorni furrat me mikrovalë, sepse janë më efikase dhe shpenzojnë më pak rrymë.
- Nëse përdorni kondicioner për ngrohje, mos e akordoni temperaturën më lartë se 19°C.
- Nëse përdorni kondicioner për freskim gjatë verës, mos e akordoni temperaturën më ulët se 26°C.
- Përdorimi i ventilatorëve është më ekonomik.
- Frigoriferin apo ngrirësin mos e vendosni afër burimeve të nxehtësisë.
- Akordoni termostatin e frigoriferit mes 3°C - 5°C.
- Derën e frigoriferit apo të ngrirësit mbani sa më pak të hapur.
- Mos vendosni ushqim të nxehtë apo të ngrohtë në frigorifer apo ngrirës.
- Mos lejoni lagështi dhe pastroni akullin e frigoriferit dhe ngrirësit.
- Akordoni termostatin e ngrirësit në 0°C.
- Mos i lini të ndezura dritat në hapësirat të cilat nuk i shfrytëzoni.
- Përdorni poçat elektrik kursyes dhe dritat e neonit.
- Instaloni sensorë që aktivizohen me lëvizje.
- Përdorni pajisjet (impiantet) më tepër gjatë natës, nga ora 22 – 07 kur rryma është me tarifë të ulët (të lirë) dhe ju do të kurseni.

## ***LISTA E PAJISJEVE ELEKTROSHTËPIAKE QË MBAJNË ETIKETA PËR EFIÇIENCËN***

---

- Frigoriferët, ngrirësit dhe kombinimet e tyre
- Makinat rrobalarëse
- Makinat rrobatharëse
- Makinat e kombinuara, rrobalarëse-rrobatharëse
- Makinat enëlarëse
- Stufat elektrike
- Kondicionerët
- Llambat elektrike.



Call Center  
038 501 701 1000 ose 038 79 1000  
[contactcenter@keds-energy.com](mailto:contactcenter@keds-energy.com)  
[www.keds-energy.com](http://www.keds-energy.com)

